

Konferencë- Mbrojtja dhe siguria në punë



Prishtinë 30 nëntor 2011 - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) organizoi, **Konferencë Kombëtare me temën Mbrojtja dhe Siguria në Punë më 25 nëntor 2011 në Hotelin Emerald.** Ky aktivitet u organizua në partneritet me organizatën turke të punëdhënësve MESS në kuadër të projektit të financuar nga Komisioni Evropian – Urat Lidhëse të Bashkëpunimit për Mbrojtjen dhe Sigurinë në Punë (European Cooperation Bridges on Occupational Health and Safety – ECBOHS). Në këtë konferencë morrën pjesë Sindikatat, Rrjeti i Grave dhe të Rinjve, përfaqësues të sindikatave ndërkombëtare, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Oda Ekonomike e Kosovës, Inspektorati i Punës, Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë, përfaqësues të ambasadave, OJQ-të, ekspertë lokal, ndërkombëtarë etj.

Kjo Konferencë kishte për qëllim sensibilizimin dhe marrjen e masave të nevojshme nga ana e punëdhënësve dhe punëmarrësve për ngritjen e nivelit të sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. U analizua gjendja aktuale dhe sfidat për arritjen e standardeve evropiane të sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

Muaji tetor ishte i shpallur nga BE-ja si muaji i sigurisë dhe shëndetit në punë. Në këtë kuadër, jo vetëm shtetet anëtare të BE-së, por edhe ato që kanë aspiratë për të hyrë në BE, kanë organizuar fushata dhe kanë ndërmarrë një mori veprimesh për të promovuar dhe zbatuar legjislacionin për sigurinë dhe shëndetin në punë si dhe për të sensibilizuar opinionin publik për rëndësinë e parandalimit dhe minimizimit të riskut të aksidenteve në punë.

Aykut Engin –Menaxher i projektit ECBOHS tha që, ”siguria në punë, mbrojtja e shëndetit të të punësuarve dhe mbrojtja e ambientit të punës, është jashtëzakonisht e rëndësishme. Dita, ditës është duke u kuptuar dhe duke u shtuar interesimi për të krijuar vende të sigurta të punës në të cilat punonjësit ushtrojnë veprimtarinë e tyre të punës. Me shtimin e kujdesit dhe shtimin e investimeve për të përmirësuar kushtet, ambientin dhe mjetet e punës në të cilat dhe me të cilat

punohet në vendet e punës, do të shtohen edhe përfitimet për punëdhënësin e njëherit do të shtohen edhe përfitimet për punonjësit, potencoi z.Aykut.

Nëse ka kushte të sigurta pune, ambient të pastër dhe të shëndetshëm dhe trajtim të duhur shëndetësor, atëherë për punonjësit ka punë pa stresse, pa frikë dhe jo të mundimshme, e që të gjitha së bashku do të ndikojnë në rritjen e efikasitetit, cilësisë dhe zvogëlimin e shpenzimeve për trajtim të punëtorëve. Masat që ndërmerren punëdhënësi në bashkëpunim me punonjësit për të ngritur shkallën e sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës, sigurisht do të ndikojnë në zvogëlimin e numrit të rasteve të aksidenteve në punë.

Shukrije Rexhepi nga BSPK-ja tha që mbrojtja dhe siguria në punë vazhdon të jetë problem mbarë botërorë. Në Kosovë mbrojtja dhe siguria në punë e punëtorëve kosovar edhe sot, pas kaq vitesh vazhdon të jetë e rëndë dhe një ndër shqetësimet kryesore të punëtorisë kosovare,

Mbrojtja dhe siguria nuk është e kënaqshme as në sektorin publik e as në atë privat e mos të flasim për sektorin informal. Shkaktar kryesorë i një gjendjeje të tillë në radhë të parë është zhvillimi tepër i ulët ekonomik .

Basri Ibrahim, kryeinspektor në Inspektoratin e Punës, tha “qëllim i yni i përbashkët është që ti bashkërendisim veprimet tona për të krijuar vende pune të sigurta, për të ndikuar sa do pak në zvogëlimin e numrit të lëndimeve dhe për ta ruajtur shëndetin e të punësuarve tonë.”

Ndërsa, Zineta Daci theksoi që me qëllim të rregullimit të kësaj lëmie Kuvendi i Kosovës ka nxjerr Ligjin 2003/19 për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarave dhe Ambientit të Punës, me të cilin janë përcaktuar në vija trasha kush gëzon siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës, cilat janë obligimet, përgjegjësitë e punëdhënësve, punëmarrësve dhe institucioneve për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave ligjore në krijimin e vendeve të punës të sigurta, të pastra dhe të shëndetshme.

Siguri në punë, mbrojtje të shëndetit gëzojnë të gjithë ata persona që gjinden aty me detyra pune, persona në aftësim profesional, persona në rikualifikim profesional, persona në rehabilitim, nxënësit dhe studentët të cilët kryejnë praktikën, persona në punë vullnetare, persona në punë publike të organizuara për interes të përgjithshëm, persona të cilët gjatë vuajtjes së dënimit angazhohen në punë, punëtor të administratës, punëtorët e institucioneve mbikëqyrëse të zbatimit të ligjeve, punonjësit e shërbimit civil, afarist, vizitor dhe persona të cilët rastësisht gjinden në vend punishte.

Në fund të këtij diskutimi kryeinspektori Ibrahim premtoi angazhim më të madh dhe pret përkrahjen e të gjithë faktorëve relevant që të ndihmojnë në drejtimin e avancimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, me synim të vetëm ta mbrojmë shëndetin, ta mbrojmë jetën, ta ngrisim vullnetin për punë, ta eliminojmë frikën dhe stresin, ta ngrisim efikasitetin në punë, ta rrisim produktivitetin, ta rrisim cilësinë dhe të krijojmë kushte që të jemi konkurrent në treg. . ***